



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0060

OSHP: 2025/0063

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibraimi-Kryesuese, Isa Hasani dhe Kimete Gashi-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) NOVUS SH.P.K., Botek shpk, kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH" me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1, me 07.04.2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesat e OE NOVUS SH.P.K., me nr. 2025/0060 e datës 22.01.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH" me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1.
2. Hedhet posht, si e palejuar sipas arsyetimit në vendim ankesa e OE Botek shpk me nr. 2025/0063, e dates: 22.01.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit" Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH" me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1.
- 3 Anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË, ndërkaq aktiviteti i prokurimit" Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH" me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1 kthehet në Rivlerësim sipas arsyetimit në këtë vendim.
4. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
5. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik NOVUS SH.P.K., Botek shpk.

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 29.11.2023, MINISTERIA E SHËNDETËSISË, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH" me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1, Autoriteti Kontraktues MINISTERIA E SHËNDETËSISË, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës punë. Vlera e parashikuar 3,800,000.00 €.

Me 03.01.2025, OE NOVUS SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Anulim të cilën AK e ka refuzuar me datën 14.01.2025.

Me datë 06.01.2025., po ashtu edhe OE Botek SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit për Anulim të Autoritetit Kontraktues. AK të njëjtën kërkesë me datën 14.01.2025 e ka refuzuar.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së OE ankues NOVUS SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP me nr. 2025/0060 e datës 22.01.2025, si dhe OE ankues Botek SH.P.K., ka parashtruar ankesë me nr. 2025/0063 të datës 22.01.2025.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 434/24 dhe ankesa nr. 439/24 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të Ankuesit NOVUS SH.P.K.,

Operatori Ekonomik PACS dhe Sistemi i Workfloës është i detyruar të mbrojë interesat e tij ekonomike dhe ligjore. Rrjedhimisht, në rast të vazhdimit të veprimeve kundërligjore, OE është i detyruar të veprojë me të gjitha mjetet ligjore në dispozicion, përfshirë kërkesat për kompensim të dëmeve eventuale që kanë ndodhur dhe do të shkaktohen. Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues në lidhje me pretendimet ankimore: Pretendimet e juaja ankimore janë trajtuar nga profesionistët e komisionit vlerësues në kuadër të DSISH dhe sipas tyre ato janë të pabazuara, në vijim gjeni arsyetimet sipas vlerësimit: 1. Lidhur me kërkesën: OE duhet të demonstrojë se produkti i ofruar është implementuar në disa arkitektura me shumë faqe. Të paktën një shembull i instalimeve në shumë vende (lokacione) duhet të dorëzohet së bashku me përshkrimin e detajuar që ilustron

madhësinë e instalimit, integrimin e realizuar dhe arkitekturën e sistemit të zbatuar. Duhet të jepet informacioni i kontaktit që mund të kërkohet si provë. MSH ka të drejtë të skualifikojë OE nëse përgjigja nga referencat nuk është e kënaqshme. Duke shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar nga OE, është evident se referencat e paraqitura për implementimin e projektit nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara në tender. Së pari, është e qartë se referencat që janë ofruar për projektet e realizuara nuk i përjasin projekteve të përfunduara, por janë ende në proces të zbatimit. Ky fakt nuk i jep asnjë garanci MSH-së se produkti i ofruar është implementuar dhe funksionon në përputhje me standardet e kërkuara. Prandaj, referencat aktuale nuk mund të konsiderohen si prova të mjaftueshme për përmbushjen e kushteve të tenderit, pasi ato nuk dëshmojnë përfundimin dhe suksesin e plotë të implementimit të sistemit në një mjedis të plotë operativ.

2. OE duhet të dëshmojë se PACS është zbatuar brenda së paku një shteti të BE-së: Përsa i përket kërkesës për të dëshmuar se PACS është realizuar brenda një shteti të Bashkimit Evropian, duhet theksuar se nuk ka asnjë dëshmi që të konfirmojë realizimin e një iniciative të natyrës së njëjtë brenda BE-së. Dëshmitë ose informacionet relevante që mund të mbështesin implementimin e këtij mekanizmi në shtetet anëtare të BE-së nuk janë të disponueshme, duke e bërë të pamundur ofrimin e një provë të tillë për realizimin e tij brenda BE-së. Nuk ka ndonjë deklaratë bindëse në të cilën dëshmohet që një projekt i ngjashëm është implementuar në ndonjë vend të BE-së, janë ofruar deklaratatë të përgjithësuara që nuk japin siguri.

3. Kërkesa e Tenderit: AK kërkon që sistemi të jetë i përshtatshëm për përdorim me pajisje specifike mjekësore, si skanera MRI dhe CT, dhe të jetë në gjendje të integrohet me pajisje të tilla pa ndërhyrje të mëtejshme. Specifikimi në Propozim: Nuk ka detaje për përshtatjen e drejtpërdrejtë të sistemit me pajisje mjekësore specifike dhe aftësinë për integrim pa probleme. Mos përputhje: Paaftësia për të siguruar integrimin e drejtpërdrejtë me pajisjet MRI dhe CT do të pengonte plotësimin e funksionaliteteve kyçe në radiologji dhe do të kërkonte zgjidhje shtesë për të mbuluar mungesat.

4. Kërkesa T: Arkitektura duhet të jetë modulare dhe fleksibël për të mundësuar zgjerime të lehta në të ardhmen pa ndryshime teknologjike të mëdha. Kjo është thelbësore për të siguruar që sistemi mund të përditësohet dhe të adaptohet me teknologjinë e re. Mospërputhja në Propozim: Propozimi nuk përmban një përshkrim të qartë të modularitetit të sistemit dhe nuk garanton fleksibilitet për zgjerime të ardhshme pa modifikime të mëdha. Mospërputhje: Mungesa e modularitetit e bën sistemin të ngurtë dhe të vështirë për tu përditësuar ose adaptuar. Çdo përditësim ose integrim i ri do të rrisë kostot dhe kohën, gjë që është e papranueshme për një sistem që duhet të jetë i qëndrueshëm dhe i përshtatshëm.

5. Kërkesa T: Specifikimi kërkon mekanizma të sigurtë për autentifikimin e përdoruesve dhe kontrollin e aksesit. Kjo është një praktikë standarte për të kufizuar aksesin vetëm për personelin e autorizuar dhe për të monitoruar përdorimin e sistemit. Mospërputhja në Propozim: Propozimi nuk përmban përshkrime për mekanizmat e MFA ose kontrollin e aksesit për të siguruar që vetëm personeli i autorizuar mund të aksesojë të dhëna të ndjeshme. Pa autentifikim të fortë dhe kontroll të aksesit, sistemi është i ekspozuar ndaj aksesimit të paautorizuar, duke rritur rrezikun e keqpërdorimit dhe shkeljeve të të dhënave të ndjeshme.

Technical specifications

6. Must have an option for lockable front panel of the server housing, restricts access to the hard disk drives. Mospërputhje: Panel i kyçshëm për aksesin në disqet e forta: Dokumenti përmend një opsion për bezel sigurie (Security bezel), por nuk ka specifikim të qartë për një panel të kyçshëm që kufizon aksesin në disqe.

7. Must have an option for a sensor to open the housing with the possibility of remote alarm settings for this event. The sensor is not part of this procurement. Mospërputhje: Sensor i hapjes së kasës: Dokumenti nuk përmend opsione për sensor që sinjalizojnë hapjen e kasës.

8. Must have an option for lockable front panel of the server housing, restricts access to the hard disk drives. Mospërputhje: Panel i kyçshëm i kasës: Dokumenti nuk përmend këtë specifikim direkt.

9. Must have an option for a sensor to open the housing with the possibility of remote alarm settings for

this event. The sensor is not part of this procurement. Mospërputhje: Sensor i hapjes së kasës: Nuk përmendet një sensor specifik për hapjen e kasës. 10. Processor: Minimum 24 cores (out of which 8 Performance-cores and 16 Efficient-cores) with total of 32 threads and 36MB intel smart cache. Frequency for the Performance-cores need to be in range of 2.0 GHz to 5.2 GHz and 1.5 GHz to 4.2 GHz on Efficient-cores. Mospërputhje: Frekuenca minimale e bërthamave Performance: Frekuenca fillestare e Performance Cores në procesorin Intel i9-13900 është 1.5 GHz, më pak se kërkesa për 2.0 GHz minimale. Vlerësim i Produkteve të Ofruara Kërkesa ka qenë të ketë MAI (Manufacturers Authorization Form) për Hardware, dhe në dosjen e ofruar nga OE, MAF (Manufacturer's Authorization Form) është nga DELL dhe njëkohësisht, si ofertë zyrtare nga OE, janë produktet e DELL.

Pretendimet e juaja ankimore Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues lidhur me kërkesën për rishqyrtim të Ankuesit Botek SH.P.K.,

Pretendimet janë të pabazuara, duke marrë parasysh se AK-MSH ka vepruar në harmoni me vendimin e OSHP-së nr. 2024-0701, sipas të cilit oferta juaj është diskualifikuar si e papërgjegjshme, lidhur me mosplotësimin e kërkesave të kapacitetit teknik dhe/ose profesional të NJT / Dosjes së tenderit - Referojuni paragrafit 1 të vendimit të OSHP-së. Paneli shqyrtues, pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorëve Ekonomikë "Virtuo O.P." dhe OE "Botek shpk" të aprovohen si pjesërisht të bazuara, megjithatë, nga të gjeturat në procedurë, dhe siç janë të përshkruara në raportin e ekspertit shqyrtues, oferta/tenderi i tij/saj janë të papërgjegjshme lidhur me mosplotësimin e kërkesave të kapacitetit teknik dhe/ose profesional të dosjes së tenderit. Bazuar në konstatimet e vendimit të OSHP-së nr. 2024-0701, është mbështetur vetëm ankesa e ofertës NOVUS SI I.P.K., ndërsa oferta juaj dhe e OE të tjerë është diskualifikuar, andaj edhe ne si AK-MSH, me të drejtë, nuk e kemi shqyrtuar gjatë rivlerësimit dhe e konsiderojmë ofertë të papërgjegjshme dhe pa interes juridik material në këtë aktivitet.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues NOVUS SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Vendimi i Autoritetit Kontraktor (AK) për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim të Grupit OE PACS and Workflow System është i pabazuar. Ky vendim është i pabazuar për shkak se në kërkesën për rishqyrtim dhe sqarimet e dhëna nga OE PACS and Workflow System, janë shpjeguar në mënyrë të mjaftueshme të gjitha pikat që AK kishte konsideruar për të vlerësuar ofertën si të përgjegjshme.

Siç është theksuar në Vendimin për eliminim dhe në Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, AK ka vlerësuar se OE PACS and Workflow System nuk ka dorëzuar një ofertë të papërgjegjshme, pasi:

1. OE PACS and Workflow System ka zhvilluar produkt në disa arkitektura në shumë faqe.
2. OE PACS and Workflow System ka zbatuar një projekt në një shtet të BE-së.
3. Nuk ka treguar se sistemi i zhvilluar do të bëjë integrimin me pajisjet me MRI dhe CT.
4. Nuk ka ofruar arkitekturë modulare fleksibile të zgjerimit në të ardhmen.
5. Nuk ka treguar për sigurimin e mekanizmave të sigurtë të autentifikimit.
6. Nuk ka mundësi për një panel të përpamë të bllokueshëm.

7. Nuk ka një sensor për hapjen e enës.
8. Nuk ka mundësi për strehimin e serverit.
9. Nuk ka mundësi për alarm.
10. Nuk ka një procesor me të paktën 24 bërthama.

Në lidhje me pretendimin e AK-së për këto pika, OE PACS and Workflow System ka paraqitur argumente dhe dëshmi që vërtetojnë se kërkesat janë përmbushur plotësisht dhe është refuzuar çdo pretendim nga AK.

Përgjigjet për pretendimet e AK-së:

1. Zhvillimi i produktit në disa arkitektura në shumë faqe:

- OE PACS and Workflow System ka paraqitur një propozim teknik që tregon se sistemi mund të operojë në një mjedis me disa faqe dhe ka shpjeguar gjithashtu ndërlidhjet mes faqeve nga pika 2.6.1 deri në 2.6.19. Ky segment përfshin një arkitekturë të avancuar që lidhet me disa faqe dhe integritime të caktuara.
- AK ka kërkuar që OE të demonstrojë implementimin në disa faqe dhe ofron një përshkrim të detajuar të arkitekturës së sistemit dhe instalimeve, të cilat janë ofruar në Propozimin Teknik.

2. Implementimi në shtete të BE-së:

- OE PACS and Workflow System ka ofruar referenca nga projekte të implementuara në Lituani (një shtet anëtar i BE-së), që janë specifikuar në Propozimin Teknik në seksionet 2.8.9 dhe 2.8.10, duke siguruar detaje për projektet dhe kontaktet për verifikimin e tyre.

3. Integrimi me pajisje mjekësore si MRI dhe CT:

- OE PACS and Workflow System ka sqaruar se sistemi është i integruar me pajisje mjekësore, përfshirë MRI dhe CT, dhe ka përmbushur kërkesën e dokumentacionit të tenderit për integrim të plotë dhe pa probleme me këto pajisje. Kjo është përfshirë në seksionin 2.6.11 të Propozimit Teknik, si dhe është sqaruar në përgjigjet për kërkesa shtesë.

4. Arkitekturë modulare fleksibile për zgjerime të ardhshme:

- OE PACS and Workflow System ka demonstruar se arkitektura e ofruar është modulare dhe fleksibile, që mundëson zgjerime të lehta në të ardhmen pa pasur nevojë për ndërhyrje teknologjike të mëtejshme. Kjo është shpjeguar në seksionet 2.6.1, 2.6.2 dhe 2.6.19 të Propozimit Teknik.

5. Sigurimi i mekanizmave të sigurtë të autentifikimit:

- OE PACS and Workflow System ka ofruar një zgjidhje të sigurt për autentifikim, e cila përfshin përdorimin e autentifikimit me dy faktorë (2FA) dhe mundësi për integrim me Microsoft AD dhe AAD për autentifikim të përdoruesve. Detajet e këtyre mekanizmave janë të përfshira në seksionet 3.3.7 dhe 6.1.5 të Propozimit Teknik.

6. Pikat nga 6 deri në 10 (Paneli i bllokueshëm, sensori për hapjen e enës, mundësia për strehimin e serverit, mundësia për alarm, dhe procesori me të paktën 24 bërthama):

- Për sa i përket serverave, OE PACS and Workflow System ka ofruar specifikime të detajuara për serverat Dell PowerEdge, përfshirë mundësitë për panel të bllokueshëm, sensorë për hapjen e enës, dhe mundësinë për alarm. Po ashtu, serverat përfshijnë procesorë me bërthama të mjaftueshme (siç është model 2 x Intel® Xeon® Silver 4514Y me 16 bërthama).
- Procesori me të paktën 24 bërthama është gjithashtu përmbushur me ofrimin e serverëve me dy procesorë dhe bërthama të mjaftueshme për të siguruar performancën e kërkuar.

Përfundimi:

Bazuar në informacionet dhe sqarimet e paraqitura nga OE PACS and Workflow System, është e qartë se të gjitha kërkesat e përfshira në dosjen e tenderit janë përmbushur plotësisht dhe me sukses. Akoma, kërkesa e AK-së për refuzimin e ofertës është e pabazuar, dhe OE PACS and Workflow System ka siguruar të gjitha dëshmitë e nevojshme që vërtetojnë përputhshmërinë e ofruesit me kërkesat e tenderit.

OE PACS and Workflow System kërkon që ky vendim të rishqyrtohet dhe të vazhdohet me procesin e nënshkrimit të kontratës.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Botek SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Përmes kësaj ankese, ne kundërshtojmë Njoftimin mbi Vendimin e AK - Ministria e Shëndetësisë, të datës 30.12.2024, për anulimin e aktivitetit të prokurimit, pa kryer një rivlerësim të lëndës, sikurse është kërkuar me vendimin e OSHP-së nr. 2024/0701; 0703; 0712, të datës 15.10.2024.

AK-MSh edhe me vendimin e tyre të datës 18.07.2024 kishte anuluar aktivitetin e prokurimit, pas të cilit kemi bërë Kërkesë për Rishqyrtim, e cila na ishte refuzuar nga AK-MSh pa dhënë arsyetimet e refuzimit, dhe me këtë rast AK kishte bërë shkelje të Nenit 108/A i LPP Nr. 04/L-042 Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, pika 9:

9. Refuzimi do të arsyetohet dhe do t’i komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër, autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim.

Pas pranimit të këtij vendimi të AK-së, ne kemi vazhduar me ankesën nr. 2024/0703 në OSHP, ku lidhur me të, OSHP ka shpallur vendimin e përmendur më sipër, datës 15.10.2024.

Sipas këtij vendimi, citat:

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit PACS dhe RIS të SISH” me nr. të prokurimit: "206-23-13309-1-1-1", të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Për më tepër, eksperti i lëndës, ndër tjerash, na ka dhënë të drejtë lidhur me refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim të AK-MSh, citat:

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimin e parë (I): Eksperti shqyrtues, pas analizimit dhe vlerësimit të pohimeve të OE ankues në raport, vendimin e AK-së për refuzimin si të pabazuar të kërkesës për rishqyrtim të OE ankues Botek Sh.p.k. dhe të tjerëve, duke u mbështetur në dispozitat relevante të LPP-së si ligj material i zbatueshëm, legjislacionit dytësor për prokurim publik, Rregullore nr. 001/2022, ka gjetur se qëndron i bazuar pretendimi i OE ankues, për faktin se AK-ja nuk ka arritur ta arsyetojë dhe argumentojë me fakte shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, si dhe cila ka qenë baza ligjore ose dispozita adekuate e zbatueshme në të cilën i bazon konstatimet e përgjithësuara në vendimin për refuzimin si të pabazuar të kërkesës për rishqyrtim të ankuesit OE Botek Sh.p.k., për faktin se nuk ka bërë një vlerësim konkret dhe nuk ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë arsyetimet lidhur me pretendimet e ngritura nga OE ankues në kërkesën për rishqyrtim, edhe pse AK-ja është dashur që të paraqesë një arsyetim të plotë dhe të qartë në vendimin e marrë. Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se një arsyetim i tillë i përgjithësuar dhe paprovuar është në kundërshtim me nenin 108/A par. 12 i LPP-së.

Pas vendimit të Panelit të OSHP-së (vendimi nr. 2024/0701; 0703; 0712), i cili ka vendosur që lënda të kthehet për rivlerësim, AK-MSH ka publikuar më 30.12.2024 dokumentin B58 Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, ku njofton anulimin e aktivitetit të prokurimit. Sidoqoftë, bashkë me këtë njoftim është bashkëlidhur vetëm Letra standarde për tenderuesin e eliminuar, drejtuar vetëm një OE/GOE, pasi që nuk është rivlerësuar e gjithë lënda për të gjithë OE/GOE-të pjesëmarrës, por vetëm oferta e GOE PACS dhe Workflow System.

Ky veprim i AK është një shkelje e rëndë e Ligjit të Prokurimit Publik dhe Rregulloreve në fuqi, të cilat garantojnë trajtim të barabartë të të gjitha OE/GOE pjesëmarrëse në aktivitetet e prokurimit. Gjithashtu, LPP dhe Rregulloret përcaktojnë në mënyrë të qartë procedurat për njoftimin e tenderuesve, sipas Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, Neni 42, që e detyron AK të informojë të gjithë tenderuesit përmes formularit B58, ku duhet të përfshihet vendimi mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe letrat përkatëse për tenderuesit, me arsyetimet e nevojshme.

Pas vendimit të OSHP-së, AK-MSH kishte mundësinë të korrigjonte shkeljet e bëra me vendimin e parë, të vërtetuara dhe nga eksperti, por jo vetëm që nuk i ka korrigjuar, por ka vazhduar me to, duke mos respektuar vendimin e OSHP-së dhe duke diskriminuar ofertën e konzorciumit tonë duke mos e rivlerësuar.

Ndër tjerash, duam të theksojmë faktin se Eksperti i lëndës ka hudhur poshtë pjesërisht pretendimet tona. Pavarësisht se ato pretendime të cilat eksperti i ka hudhur poshtë janë të faktuara nga ne me prova materiale, e të cilat as që janë marrë parasysh nga Eksperti, si dhe as nuk na është dhënë e drejta që t'i argumentojmë këto prova në seancë. Rrjedhimisht, na është mohuar e drejta që të mbrojmë faktet e pamohueshme dhe të ballafaqojmë ekspertin e lëndës me këto prova dhe ta kundërshtojmë raportin e ekspertit në pikat të cilat i ka vlerësuar si të pabazuara pretendimet tona, edhe pasi që në përgjigjen tonë ndaj raportit të ekspertit ne këtë e kemi kërkuar.

Ne rikonfirmojmë qëndrim të plotë pas të gjitha pretendimeve tona të paraqitura edhe në fazat e tjera të ankimimit, të cilat janë të mbështetura me prova të mjaftueshme se oferta e konzorciumit

tonë është e përgjegjshme administrativisht dhe teknikisht, dhe është oferta me çmimin më të ulët.

Gjithashtu, duhet theksuar se vendimi i Panelit Shqyrtues të OSHP-së është marrë në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe Rregulloren e Punës së OSHP-së. Paneli, në vendimin e tij, ka konstatuar se oferta e konsorciumit tonë është e papërgjegjshme, gjë që tejkalon kompetencat e përcaktuara për OSHP-në sipas LPP-së, Pjesa IX - PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË PROKURIMIT, neni 105 - Kompetencat e OSHP-së, si dhe Rregullores së Punës së OSHP-së, neni 23 - Nxjerrja e Urdhëresave dhe Vendimeve nga Panelet Shqyrtuese. Asnjë paragraf i këtyre dispozitave nuk autorizon Panelin Shqyrtues të OSHP-së të kryejë vlerësim ose të marrë vendim mbi vlerësimin e ofertave të OE/GOE-ve pjesëmarrës në ankesë.

-Vlerësimi dhe administrimi i provave-

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me datë 23.01.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0060/2025 ndërsa me datë 03.02.2025 janë dorëzuar raportet e ekspertizës të ekspertit shqyrtues.

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) me datë 23.01.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0063/2025 ndërsa me datë 03.02.2025 janë dorëzuar raportet e ekspertizës të ekspertit shqyrtues.

Lidhur me ankesën nr. 0060/2025 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën Nr. 0060/2025 të operatorit ekonomik NOVUS SH.P.K.

Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ngritura në ankesën e operatorit ekonomik të cekur më sipër dhe me këtë rast konform vlerësimin të pavarur dhe profesional sipas përgjegjësisë së tij ligjore në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP-së lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores, paraqet vlerësimet dhe të gjeturat si në vijim:

Bazuar në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, eksperti sqaron se, ankuesi është eliminuar nga procesi i prokurimit me arsyetimin se nuk e ka plotësuar formularin e paraqitjes së tenderit në platformën elektronike (e-prokurim) ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit, Shihni ju lutem pjesën e arsytimit nga letra standarde në platformën e-prokurimi.

Ankuesi (me të dhëna si më sipër) ka atakuar vendimin e AK për anulimin e aktivitetit të cituar si më sipër nga aspekti i eliminimit të tij/sajë, në pretendimin e parë lidhur me referencat dhe sipas kërkesës nga AK për zbatimin e PACS brenda sëpaku një shteti të BE-së., dhe në pretendimet ankimore 3 ,4 dhe 5, përmes pohimeve të specifikuar në 10 pika të kësaj ankese lidhur me atakimin e arsytimit të dhënë në letrën standarde për eliminimin e tij për shkak të mosplotësimit të kriterëve të stafit profesional sipas kërkesës së kapacitetit teknik dhe/ose profesional të dosjes së tenderit, për të cilat eksperti shqyrtues konsideron se nuk ka nevojë që të njëjtat të përshkruhen në detaje ose më gjerësisht në këtë rast, por do të prezentohen shkurtimisht për nevojat e vlerësimin të ekspertizës përderisa të njëjtat në aspektin e tërësishëm janë

përshkruar në pjesën përkatëse të lartcekur të kësaj ekspertize. Andaj duke u bazuar në përshkrimin e pretendimeve enakimore, eksperti shqyrtues sqaron se kemi gjetur se ankesa bazohet në çështje kryesore

- eliminimin për mosplotësimin e kërkesave të kapacitetit teknik dhe/ose profesional lidhur me stafin profesional, dhe specifikacionet teknike

Eksperti shqyrtues, pasi i ka krahasuar të gjitha pohimet e pretendimeve enakimore në aspektin analitik në raport me arsyet e eliminimit të tij/sajë, dhe nga ana tjetër duke e analizuar dosjen e tenderit si dhe dokumentet me të cilat ka ofertuar ankuesi si GOE në raport me kushtet dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe të gjitha shkresat tjera në tërësinë e tyre, gjithashtu duke ju referuar dispozitave përkatëse të LPP-së dhe legjislacionit dytësor për prokurim publik, eksperti jep konstatimin dhe vlerësimin e tij sipas arsytimit të më poshtë:

Pretendimi i parë dhe i dytë : Lidhur me arsyen të eliminimit të tij në të cilin thuhet, “referencat e paraqitura nuk përmbushin kërkesën e AK-së, sipas sqarimit të kërkuar nga AK-ja të datës:13.12.2024 dhe përgjigjejen e kthyer nga OE ankues më datë ; 19.12.2024, (shih sqarimin në platformën e e-prokurimit) në dosjen e tenderit, OE ankues dhe GOE e kanë plotësuar siç duhet kërkesën ashtu siç është e paraqitur në platformën elektronike të prokurimit së bashku me ofertën e tyre me numër rendor 4.2 dhe 4.3. ky pretendim është i bazuar.

Lidhur me pika enakimore 3,4 dhe 5 Eksperti shqyrtues konstaton se në sqarimet e ofruar nga OE ankues të datës 19.12.2024, janë të detajuar dhe po të njëjta janë të bashkangjitura në ofertën e OE ankues sipas numërit rendor 2, ,4 (4.1, 4.2 ,4.3, 4.5 dhe 4.6) si dhe me failin nr.7.

Ky konstatim i ekspertit shqyrtues mund të konfirmohet përmes dokumenteve relevante të ofertës së OE ankues lidhur me dokumentacionin e ofruar dhe përmbushjen e kërkesave sipas AK-së,.

Duhet theksuar se gjatë faz fazës së parë të vlersimit AK kishte konstatuar se OE ankues në këto pika ishte i përgjegjshëm , andaj kishte marrë vendim për elimin për mos plotësimin e kërkesave kualifikuese por sipas Vendimit të PSH-së , nr. 2024/0712, 2024/0703 dhe 2024/0701, pretendimet enakimore ishin aprovuar dhe lënda është kthyer në rivlersim.

Prandaj duke u nisur nga ky vlerësim analitik i shpjeguar si më lart, eksperti shqyrtues vlerëson se arsyetimi i eliminimit në këtë pikë i dhënë në letrën standadre për OE ankues nuk është në përputhje me nenin 59 të LPP-së dhe dispozitat tjera relevante të këtij ligji dhe legjislacionit dytësor të prokurimit publik që parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, për faktin se nuk është në interes të parimeve të ligjshmërisë të LPP-së të përcaktohen praktika të gabuara duke bërë zbatim jo adekuat të ligjit. Për këto arsye, eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim është i bazuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë përgjigjen për mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues, ndërsa Operatori ekonomik është pajtuar me mendimin e dhënë nga eksperti shqyrtues.

Lidhur me ankesën nr. 0063/2025 është dorëzuar raporti me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërishtë e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën Nr. 0063/2025 të operatorit ekonomik Botek SH.P.K.

Eksperti shqyrtues i prokurimit, pas shqyrtimit të pretendimeve lidhur me vendimet e PSH-ës, analizimit të shkresave të kësaj lënde të dokumentuara në platformën e-prokurimi, duke u mbështetur në LPP si ligj material dhe rregullat e prokurimit publik (RRPP), eksperti shqyrtues vlerëson se mbështetur në vendimet e panelit shqyrtues OSHP:2024/0712. 2024/0703/ dhe 2024/0701., janë përfundimtare/detyruese për palët dhe si të tilla i nënshtrohen kontrollit gjyqësor me mjete juridike bazuar në nenin 119 të LPP-së.

Në këtë kontekst, eksperti shqyrtues duke vepruar në kuptim të nenit 16 paragrafit 2 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, e njofton panelin shqyrtues se palët janë të njejta (AK-OE ankues) objekti i këtij pretendimi është i njejtë dhe është shqyrtuar më parë me vendimet nr. 2024/0712, 2024/0703 dhe 2024/0701, andaj për këto arsye, i propozon panelit shqyrtues që këtë çështje të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”.

Ndërsa s ai përket pretendimit ankimor nga OE ankues lidhur me mos respektimin e nenit 7 dhe 59 të LPP-së, nga ana e AK-së , ESH konstaton si në vijim:

Konstatimi i ekspertit shqyrtues për pretendimin ankimor lidhur me mos vlersimin dhe ekzaminimin e ofertave : Pas shqyrtimit të këtij pretendimi ankimore, analizimit të shkresave të kësaj lënde të dokumentuara në platformën e-prokurimi, duke u mbështetur në LPP si ligj material dhe rregullat e prokurimit publik (RRPP), eksperti shqyrtues vlerëson se qëndronë i bazuar pretendimi i lartcekura të OE ankues, për faktin se bazuar në vendimet e PSH-së, AK gjatë ri-vlersimit bazuar në nenin 7 dhe 59 të LPP-së është dashur që të konstatohen të gjeturat dhe rrjedhimisht të përshkruhen në raportin e ri-vlersimit nga komisioni për ri-vlersim , egzaminimin dhe krahasim të ofertave të OE ankues.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët në procedurë, ku Autoriteti Kontraktues po ashtu dhe Operatori ekonomik nuk kanë dhënë përgjigje në mendimin e ekspertit shqyrtues.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, ku nga OSHP-ja kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi

aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Lidhur me ankesën me nr 2025/0060 e datës 22.01.2025

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit ‘Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH’ me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1.

Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues për këtë procedur të prokurimit tek Autoriteti Kontraktues bazuar raportin e ekspertit shqyrtues si dhe në të gjeturat përmes plaformës elektronike ka vu re se sipas publikimit të B58 Njoftim mbi vendimin e AK të datës 18.07.2024 ka eliminuar OE ankues kryesisht me arsytim se nuk janë plotësuar kërkesat lidhur me stafin si dhe nën kriteret e vendosura, ndërsa sipas B58 Njoftimit mbi vendimin e AK-së te dates 30.12.2024, janë ofruar arsytetime tjera gje qe ka ndryshime rënjësore në rivlersim e të cilat nuk jane në përputhje me nenin 59 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK-ja gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, ngase raporti i vlersimit të më hershëm dhe rivlersimit lidhur me ofertën e OE ankues lidhur me rezultatin e oferës ka dallime esenciale, Si rrjedhojë, Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së për aktivitetin e prokurimit : Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH” me numër të prokurimit 206-23-13309-1-1-1, dhe lënda të kthehet në Rivlerësim, dhe AK-ja gjatë rivlerësimit të këtij aktiviteti të prokurimit të ju përmbahet në tërsi dispozitave ligjore të LPP-së, si dhe konstatimeve në të gjeturat e evidentuara nga eksperti shqyrtues ne raportin e ekspertizës.

Lidhur me ankesën e OE Botek SH.P.K. me nr 2025/0063, Paneli Shqyrtues e Hedhë poshtë si të pa lejuar ngase sipas vendimit OSHP: 2024/0703; OSHP: 2024/ 0712, oferta/tenderi i tij/sajë është konsideruar e pa papërgjegjshme lidhur me mosplotësimin e kërkesave të kapacitetit teknik dhe/ose profesional të Njoftimit per Kontratë / Dosjes së Tenderit Andaj në kuptim të nenit 4 paragrafi 2.26 ky OE nuk mund të konsiderohet si pale e interesuar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Përfundim:

Paneli Shqyrtues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Ky vendim është përfundimtar dhe duhet të zbatohet nga Autoriteti Kontraktues në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik. Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP, konkretisht në nenin 1,7 të LPP-se, dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicoj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË, MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - NOVUS SH.P.K., Botek shpk**
- Arkivës së OSHP-së: